



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 03 maj 2019
Nr. ref.: RK 1357/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI12/19

Parashtrues

Arben Mërxha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
Pml. nr. 313/2018, të 10 dhjetorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Arben Mërxha, me vendbanim në Pejë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), Pml. nr. 313/2018, të 10 dhjetorit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 23 janar 2019, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të cilën ai e kishte dorëzuar nëpërmjet postës, më 21 janar 2019.
6. Më 28 janar 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Selvete Gërxhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 15 shkurt 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoi që të dorëzojë në Gjykatë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore (P. nr. 72/2016) dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit (PA1. nr. 595/2018).
8. Në të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 13 mars 2019, Gjykata i pranoi dokumentet e kërkuara me shkresën e 15 shkurtit 2019, të cilat ishin dorëzuar nëpërmjet postës, më 9 mars 2019.
10. Më 10 prill 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës, dhe me shumicë votash për shkak se kërkesa është e papajtueshme *ratione materiae* me Kushtetutën.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 7 maj 2012, parashtruesi i kërkesës, në cilësi të paditësit subsidiar, inicioi padi penale në Gjykatën Themelore në Pejë kundër personit G. D., duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale sipas nenit 219, [Trajtimi i Pandërgjegjshëm Mjekësor] të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, të 6 korrikut 2003 (në tekstin e mëtejme: KPPK).
12. Më 28 dhjetor 2012, Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale (në tekstin e mëtejme: KPP) u shpall në Gazetën Zyrtare.
13. Më 20 tetor 2015, Gjykata Themelore në Pejë, përmes Aktgjykimit P. nr. 882/2012, liroi nga akuza personin G. D. për veprën penale trajtim i pandërgjegjshëm mjekësor.
14. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë [P. nr. 882/2012], në Gjykatën e Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).
15. Më 22 mars 2016, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA1. nr. 1423/2015] aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe rastin e riktheu për rivendosje në Gjykatën Themelore.
16. Më 8 mars 2018, Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Deçan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), përmes Aktgjykimit P. nr. 72/2016, liroi nga akuza e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, si paditës subsidiar, personin G. D. për veprën penale trajtim i pandërgjegjshëm mjekësor. Për të realizuar kërkesën pasurore juridike, Gjykata Themelore e udhëzoi parashtruesin e kërkesës në kontest civil.
17. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [P. nr. 72/2016] në Gjykatën e Apelit.
18. Më 23 gusht 2018, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit (PA1. nr. 595/2018), refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore (P. nr. 72/2016).
19. Më 9 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Zyra e Kryeprokurorit), propozimin për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (P. nr. 72/2016) dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (PA1. nr. 595/2018).
20. Më 10 tetor 2018, Zyra e Kryeprokurorit (Njoftim A. nr. 361/18) e këshilloi parashtruesin e kërkesës që kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, siç parashihet me dispozitat e KPPK-së, ta dorëzojë në Gjykatën Themelore, *“që më pas e njëjta të shqyrtohet sipas procedurave”*.
21. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (P. nr.

72/2016) dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (PA1. nr. 595/2018), për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal. Prokurori i Shtetit, me parashtresën KMLP. II. nr. 219/2018, paraqiti përgjigje në kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë duke propozuar që ajo të hedhet poshtë si e palejuar.

22. Më 10 dhjetor 2018, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit (Pml. nr. 313/2018), hodhi poshtë si të papranueshme kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore (P. nr. 72/2016) dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (PA1. nr. 595/2018), pasi konstatoi se sipas nenit 433 të KPP-së, kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë mund ta paraqesë Prokurori i Shtetit dhe i pandehuri ose mbrojtësi i tij, por jo paditësi subsidiar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij kushtetuese, të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.
24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, Gjykata Supreme, duke konstatuar se kërkesa e tij për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [P. nr. 72/2016] dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [PA1. nr. 595/2018] nuk është e lejuar, pasi vetëm Prokurori i Shtetit dhe i pandehuri, kanë të drejtë që të paraqesin kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe jo paditësi subsidiar, ka aplikuar gabimisht KPP-në.
25. Argumentin e tij në lidhje me këtë pretendim ai e ndërton duke u bazuar në faktin se sipas nenit 65 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPP), i aplikueshëm në kohën kur është paraqitur padia subsidiare, paditësi subsidiar gëzon të njëjtat të drejta të cilat i gëzon edhe prokurori publik. Ndërsa, edhe pse me KPP-në nuk është paraparë mundësia e padisë subsidiare, është paraparë vazhdimi i procedurës në lidhje me paditë subsidiare të filluara sipas KPPP-së, pasi neni 543 [Vazhdimi i padisë private] i KPP-së, parashihet që për veprat penale për të cilat kryerësi ndiqet me padi private ose padi subsidiare, procedura e tillë vazhdon në kuadër të departamentit të përgjithshëm të Gjykatës Themelore përkatëse dhe zbatohet përshtatshmërisht dispozitave të KPP-së.
26. Andaj, në lidhje me këtë, parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme, duke aplikuar gabimisht KPP-në në ndërlidhje me KPPP-në, i ka shkelur parashtruesit të drejtën për qasje në drejtësi sipas nenit 31 të Kushtetutës, pasi nuk është futur në meritat e rastit për të vlerësuar shkeljet që janë bërë nga Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, sipas padisë subsidiare të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës.

27. Parashtruesi po ashtu pretendon se njoftimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit [A. nr. 361/18], me të cilin parashtruesi udhëzohet që të paraqesë kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ishte i gabuar, ndërsa mosngritja e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë nga Prokurori i Shtetit në favor të parashtruesit të kërkesës, ashtu si ishte kërkuar nga parashtruesi, i ka shkaktuar dëm esencial të pariparueshëm parashtruesit të kërkesës.
28. Parashtruesi i kërkesës në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore (P. nr. 72/2016) dhe Aktgjykimin të Gjykatës së Apelit (PA1. nr. 595/2018) thekson se Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit: a) kanë shkelur të drejtën për një vendim gjyqësor të arsyetuar dhe parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, dhe b) nuk kanë vlerësuar si duhet faktet e paraqitura nga ai dhe ekspertizat e ekspertëve. Në mbështetje të pretendimeve të tij, parashtruesi i kërkesës kishte cituar disa raste të praktikës së GJEDNJ-së që ndërlidhen me të drejtën për një vendim të arsyetuar.
29. Parashtruesi në fund kërkon nga Gjykata që të deklarojë kërkesën të pranueshme, të konstatojë se ka pasur shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë, si dhe të anulohen vendimet e Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit, Gjykatës Supreme, dhe Njoftimi i Zyrës së Kryeprokurorit 361/18.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

32. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

33. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Pml. nr. 313/2018] të 10 dhjetorit 2018 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

34. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (3) i Rregullores së punës, përcakton që:

“[...]

(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]

(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën”.

35. Gjykata, para së gjithash, vëren se parashtruesi në kërkesë i referohet shkeljes së disa neneve të Kushtetutës, megjithatë, thelbi i këtyre pretendimeve ka të bëjë me të drejtën për qasje në drejtësi, aplikimit arbitrar të ligjit dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

36. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës, në pjesën përkatëse të paragrafit të dytë të tij përcakton:

“Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale [...]”.

37. Gjithashtu, neni 6 (E drejta për një proces të rregullt), paragrafi 1 i KEDNJ-së, në pjesën përkatëse, përcakton:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile e çdo akuze penale në ngarkim të tij [...]”.

38. Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, sipas së cilës KEDNJ *“nuk garanton të drejtën e inicimit të procedurës penale kundër palëve të treta, [dhe], neni 6 i KEDNJ-së nuk i referohet veprimeve të cilat kanë për qëllim inicimin e procedurave penale kundër palëve të treta* (shih, Vendimin e Komisionit Istváné Rékási kundër Hungarisë, Kërkesa nr. 31506/96 , e 25 nëntorit 1996).

39. Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore, ku kishte konkluduar se KEDNJ *“nuk siguron të drejtën e ndjekjes ose dënimit të një pale të tretë për një vepër penale. As Kushtetuta nuk ofron një të drejtë të tillë”*. (shih, Aktvendimi për papranueshmëri në rastin KI97/14, Velibor Jokić i 8 dhjetorit 2015, paragrafi 38, Aktvendimi për papranueshmëri në rastin KI52/18, Zoran Stanišić, i 16 janarit 2019, paragrafi 51).

40. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se kur lexohet neni 31 i Kushtetutës, në kuptimin e nenit 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së, rrjedh se shprehja *“për çfarëdo ndjekje penale”* që përdoret në nenin 31, duhet kuptuar si *“çfarëdo kallëzimi penal të paraqitur kundër parashtruesit të kërkesës”* (shih Aktvendimin për papranueshmëri në rastin KI52/18, Zoran Stanišić, i 16 janarit 2019, paragrafi 49).

41. Përveç kësaj, në lidhje me *“të drejtat dhe obligimet”*, Gjykata rikujton se GJEDNJ kishte deklaruar se megjithëse KEDNJ nuk parasheh *“të drejtën për të ndjekur penalisht palët e treta në mënyrë të pavarur, apo për të dënuar për një vepër penale: ushtrimi i kësaj të drejte duhet të jetë e pandashme nga ushtrimi i një të drejte të viktimës për të ushtruar të drejtën për procedurë civile në të drejtën vendore, edhe në qoftë se kjo është vetëm për të siguruar dëmshpërblim simbolik ose për të mbrojtur një të drejtë civile [...]”*. (Shih, rastin e GJEDNJ-së, Perez kundër Francës, nr. 47287/99, Aktgjykimi i 12 shtatorit 2004, para. 70. Shih po ashtu, *mutatis mutandis*, edhe rastin e GJEDNJ-së, Rekić kundër Bosnje Hercegovinës nr. 39894/11, Vendim i 29 marsit 2018, para. 24).

42. Gjykata vëren se në rastin konkret, pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës, kanë të bëjnë me procedurën penale që ai kishte iniciuar kundër palës së tretë, përkatësisht personit G. D., duke e akuzuar për kryerjen e veprës penale sipas nenit 219 [Trajtimi i Pandërgjegjshëm Mjekësor] të KPPK-së, ku parashtruesi i kërkesës ishte në cilësinë e paditësit subsidiar.

43. Akuza penale e parashtruesit të kërkesës kundër palës së tretë u refuzua nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit, me arsyetimin se nuk ishte provuar që i akuzuari kishte kryer veprën penale për të cilën akuzohej, ndërsa Gjykata Supreme e deklaroi kërkesën e parashtruesit si të papranueshme pasi konsideroi se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë sipas nenit 433 të KPP-së mund ta paraqesë vetëm Prokurori i Shtetit dhe i pandehuri ose mbrojtësi i tij, por jo edhe paditësi subsidiar.

44. Në këtë mënyrë, pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë, gjatë zhvillimit të procedurës kundër personit të tretë, G.D. nuk bie në kuadër të fushëveprimit të titullit “*si çfarëdo ndjekje penale*” që gjendet në nenin 31 të Kushtetutës.
45. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se ankesa e parashtruesit të kërkesës lidhur me procedurën penale kundër palës së tretë, në këtë rast G. D., nuk bie në kuadër të drejtës për gjykim të drejtë nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së, andaj, kërkesa e parashtruesit nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
46. Gjykata vëren, gjithashtu se parashtruesi i kërkesës para gjykatave të rregullta kishte ngritur çështjen pasurore juridike, që ndërlidhet me të drejtën për mbrojtje të pronës.
47. Në lidhje me këtë, Gjykata Themelore në Aktgjykimin P. nr. 72/2016, kishte udhëzuar parashtruesin në procedurë të rregullt civile lidhur me kërkesën pasurore juridike ndaj personit G. D.
48. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka ngritur çështjen e kërkesës së tij pasurore juridike në mënyrë specifike para Gjykatës dhe nuk ka specifikuar në kërkesë nëse, për të realizuar kërkesën e tij pasurore juridike, ai ka ushtruar mjetet juridike që i kishte në dispozicion.
49. Si përfundim, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113, paragrafi 7, të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës, më 10 prill 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi